

VENDIM
Nr.80, datë 12.2.2012

PËR SHPALLJEN E GJENDJES SË EMERGJENCËS CIVILE (FATKEQËSISË NAYRORE) NË NJËSITË E QEVERISJES VENDORE TË QARQEVE SHKODËR, KUKËS, DIBËR, KORÇË DHE RRETHIN E LIBRAZHBIT

Në mbështetje të neneve 100 e 174 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 2 shkronja “c”, e 6 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e gjendjes së emergjencës civile (fatkeqësisë natyrore), si pasojë e përkeqësimit të kushteve natyrore të motit në njësitë e qeverisjes vendore të qarqeve Shkodër, Kukës, Dibër, Korçë dhe rrethin e Librazhdit.

2. Ngritjen e Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile, i cili të kryesohet nga Kryeministri dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:

- Ministrin e Brendshëm;
- Ministrin e Mbrojtjes;
- Ministrin e Financave;
- Ministrin e Punëve Publike dhe Transportit;
- Ministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
- Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
- Ministrin e Shëndetësisë;
- Ministrin e Arsimit dhe Shkencës;
- Ministrin e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;
- Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;
- Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;
- Drejtorin e Përgjithshëm të Emergjencave Civile.

3. Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile të bashkërendojë punën me ministritë e linjës, me institucionet qendrore e rajonale, në varësi të ministrive të linjës, me institucionin e prefektit të qarqeve Shkodër, Kukës, Dibër, Korçë dhe nënprefektin e Librazhdit, si dhe me të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e emergjencës civile, për zbatimin e detyrave në varësi të situatës, për garantimin e sigurisë së jetës të banorëve, për sigurimin e veprimtarisë normale për jetesë të komuniteteve të prekura në këto zona, si dhe për marrjen e masave parandaluese, mbrojtëse e rehabilituese në infrastrukturën dhe mjedisin e prekur nga situata e krijuar.

4. Ngarkohen Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile, Ministri i Brendshëm, ministritë e linjës, prefektët e qarqeve Shkodër, Kukës, Dibër, Korçë dhe nënprefekti i Librazhdit, si dhe njësitë e qeverisjes vendore përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha